



Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 21, 22, 44, 53 dhe 84 të Ligjit Nr. 05/L-03 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 17, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 350/03-190763/21 dt. 10.09.2021, të pronarëve Ferat Zariqi, Visar Zariqi, Izet Berisha, Latif Zariqi, Sali Zariqi dhe "Pushkolli Group" shpk nga Prishtina, dhe investitorit "Pushkolli Group" shpk, me seli në Vushtrri, rr. "Shote Galica" pn, në Vushtrri, për miratimin e ndryshimit/plotësimit të kushteve ndërtimore të caktuara me aktin administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore" 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 20.12.2018, dhe ricaktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore dhe afariste, në kuadër të parcelës ndërtimore të bllokut urban "B3.2", të tërësisë hapësinore "Qendra" të Ndryshimi dhe Plotësimi i Planit Rregullues "Arbëria 3" në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit në procedurë administrative, me datë 26.07.2022, merr këtë:

#### V E N D I M

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR NDRYSHIMIN/PLOTËSIMIN E AKTIT ADMINISTRATIV "VENDIM PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE" 05 NR. 350/02-0232206/18 DT. 20.12.2018, SHFUQIZIMIN E TIJ DHE RICAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

**I. Miratohet** kërkesa 05 Nr. 350/03-190763/21 dt. 10.09.2021, në emër të pronarëve Ferat Zariqi, Visar Zariqi, Izet Berisha, Latif Zariqi, Sali Zariqi dhe "Pushkolli Group" shpk nga Prishtina, dhe investitorit "Pushkolli Group" shpk, me seli në Vushtrri, me numër unik identifikues nr. 810007759, dhe me person të autorizuar Betim Kokollari nga Vushtrria, për ndryshimin/plotësimin e kushteve ndërtimore të caktuara me aktin administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore" 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 20.12.2018, përkatësisht shfuqizimin e tij, dhe ricaktimin e kushteve ndërtimore.

**II. Shfuqizohet** akti administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore" 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 20.12.2018, i nxjerr nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në emër të pronarëve Ferat, Latif, Salih, Visar Zariqi, Izet Berisha, nga Prishtina, me investitor NNP "Standard" shpk, me adresë në lagjen "Dardani" SU 1/3 A, në Prishtinë, me nr. të biznesit 80100540, përfaqësuar nga Vehbi Zariqi, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, për ndërtimin e kompleksit të ndërtesave, në kuadër të bllokut urban "B3.2", ndërtesës shumëbanesore me afarizëm "B", me etazhitet 2B+S+P+5 dhe sip. Mbi tokë 2704.25 m<sup>2</sup>, dhe ndërtesës afariste "C", me etazhitet 2B+S+P+5, dhe sip. Mbi tokë 2520.25 m<sup>2</sup>, në parcelat kadastrale nr. 7178-1, 7178-2, 7178-3, 7178-4, 7178-6 dhe në pjesë të parcelës kadastrale 7178-13 ZK Prishtinë.

**III. U ricaktohen kushtet ndërtimore** pronarëve Ferat Zariqi, Visar Zariqi, Izet Berisha, Latif Zariqi, Sali Zariqi dhe "Pushkolli Group" shpk nga Prishtina, investitorit "Pushkolli Group" shpk, me seli në Vushtrri, me numër unik identifikues nr. 810007759, dhe me person të autorizuar Betim Kokollari nga Vushtrria, sipas kërkesës 05 Nr. 350/03-190763/21 dt. 10.09.2021, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste, në kuadër të zonës "B3.2", të bllokut urban "B3", të tërësisë hapësinore "Qendra" të Ndryshimit dhe Plotësimit të Planit Rregullues "Arbëria 3" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10272-0 ZK Prishtinë, dhe me trajtim përmes shpronësimit/ kompensimit me

koeficient të ndërtimit edhe të parcelës kadastrale nr. 7178-18, 7178-20, 7178-22, dhe 7178-23 ZK Prishtinë.

**IV. Lokacioni** për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të Ndryshimi dhe Plotësimi i Planit Rregullues "Arbëria 3", miratuar me Vendimin e Komunës së Prishtinës 01 nr. 035-94056 dt. 04.05.2015, ku sipas këtij plani, kjo hapësirë është e destinuar si "zonë e banimit miksi".

**V. Gjendja ekzistuese** e lokacionit-parcelës kadastrale, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:
  - nr. 7178-18.....S=21 m<sup>2</sup>.....Ferat Zariqi, Visar Zariqi, Izet Berisha, Latif Zariqi, Sali Zariqi, ..... "arë e klasës 3";
  - nr. 7178-20.....S=16 m<sup>2</sup>.....Ferat Zariqi, Visar Zariqi, Izet Berisha, Latif Zariqi, Sali Zariqi..... "arë e klasës 3";
  - nr. 7178-22.....S=24 m<sup>2</sup>.....Ferat Zariqi, Visar Zariqi, Izet Berisha, Latif Zariqi, Sali Zariqi..... "arë e klasës 3";
  - nr. 7178-23.....S=358 m<sup>2</sup>.....Ferat Zariqi, Visar Zariqi, Izet Berisha, Latif Zariqi, Sali Zariqi..... "arë e klasës 3";
  - nr. 10272-0.....S=2075 m<sup>2</sup>.....Ferat Zariqi, Visar Zariqi, Izet Berisha, Latif Zariqi, Sali Zariqi dhe "Pushkolli Group" shpk..... "arë e klasës 3";
- E drejta pronësore-juridike e parcelave kadastrale të lartcekura, në bazë të certifikatave të njësive kadastrale, është private, dhe janë tokë e ndërtuar, me kyçe në infrastrukturë teknike: rrugë, ujësjellës, kanalizim, elektrikë dhe telefoni;
- Terreni ka pjerrtësi /disnivel nga drejtimi verilindje në jugperëndim, me disnivel ~4.50 m';
- Qasja ekzistuese e parcelavekadastrale të lartcekura, është përmes rrugës lokale ekzistuese e cila është edhe rrugë e planifikuar e planit rregullues, në anën verilindore të bllokut urban;
- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50 m' ka ndërtesa ekzistuese, si: ndërtesa shumë banesore dhe shtëpi banimi, etj.;

**VI. Kushtet ndërtimore** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar në kuadër të parcelës ndërtimore të kompleksit, e përfshirë në kuadër të zonës "B3.2", të bllokut urban "B3", të tërësisë hapësinore "Qendra" të Ndryshimit dhe Plotësimi të Planit Rregullues "Arbëria 3" në Prishtinë, përcaktohen duke konsultuar, analizuar, si dhe mbështetur në dokumentet e planifikimit hapësinor, projekt propozimin e prezantuar, gjendjen ekzistuese të lokacionit dhe rregullativën ligjore në fuqi, dhe ato janë:

- Parcela ndërtimore, organizimi, gabariti, pozicionimi dhe etazhiteti i ndërtesës, qasja në kompleks si dhe raporti i ndërtesës me vijën rregulluese dhe ndërtimore, distancat në mes ndërtesave dhe nga kufiri i parcelës ndërtimore, rrugët dhe vendparkimet e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të planifikohen sipas kriterëve të planit rregullues urban dhe kriterëve të përcaktuara në pikat e këtij paragrafi, duke u bazuar në "Plani i lokacionit-"zgjdhja urbane", si dhe "Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Ndryshimi dhe Plotësimi i Planit Rregullues "Arbëria 3" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01", bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Parcela kadastrale me sipërfaqen e trajtuar, në pjesën e zonës "B3.2", të bllokut urban "B3", për realizimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste, që përfshihet në ndërtim-parcelë ndërtimore, e trajtuar **brenda vijës rregulluese**, është:
  - nr. 10272.....S=2075 m<sup>2</sup>

**Sipërfaqe e përgjithshme e parcelës ndërtimore, brenda vijës rregulluese, është S=2075 m<sup>2</sup>;**

- Parcelat kadastrale me sipërfaqen e trajtuar, në pjesën e zonës "B3.2", të bllokut urban "B3", për realizimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste, që përfshihennë ndërtim-parcelë ndërtimore, konkretisht pjesët e parcelave kadastrale të trajtuara, **jashtë vijës rregulluese**, janë:
  - nr. 7178-18.....S=21 m<sup>2</sup>;
  - nr. 7178-20.....S=16 m<sup>2</sup>;
  - nr. 7178-22.....S=24 m<sup>2</sup>;
  - nr. 7178-23.....S=354+4 m<sup>2</sup>;

**Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave jashtë vijës rregulluese, e trajtuar sipas Vendimit 01 Nr. 400-660 dt.26.05.2008 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës.....S=415 m<sup>2</sup>;**

- Parcela kadastrale nr. 10272 ZK Prishtinë, me sipërfaqe S=2075 m<sup>2</sup> është formuar pas bashkimit dhe ndarjes së parcelave kadastrale, të përfshira brenda vijës rregulluese, bazuar në aktin administrativ “Kushte Ndërtimore” 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 20.12.2018, të kësaj drejtorie;
- Parcela kadastrale nr. 7178-18, 7178-20, 7178-22 dhe 7178-23 ZK Prishtinë, me sipërfaqe S=419 m<sup>2</sup>, është formuar pas përfundimit të procedurës së shpronësimit/kompensimit të pronës private, bazuar në aktin administrativ “Kushte Ndërtimore” 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 20.12.2018, të kësaj drejtorie, dhe e njëjtat kanë kaluar në pronësi komunale, dhe të njëjtat do të trajtohen sipas Vendimit “Kushte Ndërtimore” 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 20.12.2018;
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste, në zonën “B3.2”, të bllokut urban “B3”, të tërësisë “Qendra”, planifikohet të ndërtohet ndërtesa shumë banesore dhe afariste, e organizuar në hyrje, me sipërfaqe ndërtimore mbi tokë dhe nën tokë, si në vijim:

**Kompleksi me ndërtesë shumë banesore dhe afariste**

**“Ndërtesa”**

S=7680.35m<sup>2</sup> / 5229.00 m<sup>2</sup>, mbi tokë+2451.35 m<sup>2</sup>, nën tokë /,  
Etazhitet: -2B+S+P+7

- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës kadastrale-parcelës ndërtimore (ISHP), konkretisht shfrytëzimi i parcelës brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesave në bazën-gabaritin e përdheses ose suteranit është max. 0.30 (30 %), dhe sipas llogarive, projekt propozimit dhe e miratuar, kjo sipërfaqe është:  
S=2075x0.3=622.50 m<sup>2</sup> /lejuar sipas planit rregullues /,  
S=619.48m<sup>2</sup> / sipas projekt propozimit, për përdhesë dhe suteran /;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës kadastrale-parcelës ndërtimore (ISHPN), konkretisht shfrytëzimi i parcelës brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesave në bazën-gabaritin e bodrumit, është max. 0.60 (60 %), sipas planit rregullues dhe bazuar në paragrafin II, pika 1. të Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, dhe sipas llogarive, projekt propozimit dhe e miratuar, kjo sipërfaqe është:  
S=2075x0.6=1245.00 m<sup>2</sup> / lejuar sipas planit rregullues dhe Vendimit të Kryetarit /;  
S=1148.24 m<sup>2</sup> / sipas projekt propozimit /.
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për hapësira gjelbëruese (ISGJ), sipas planit rregullues dhe bazuar në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është 0.4 (40%), dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, 0.3 (30 %), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe sipas llogarive, projekt propozimit dhe e miratuar, kjo sipërfaqe është:  
S=2075x0.4=830.00 m<sup>2</sup> / lejuar sipas planit rregullues dhe Vendimit të Kryetarit /;  
S=2075x0.3=622.50 m<sup>2</sup> / lejuar sipas Vendimit të Kryetarit /;  
S=830.32 m<sup>2</sup> / sipas projekt propozimit, mbi tokë.
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) për zonën “B3.2” të bllokut urban “B 3”, sipas planit rregullues, është max. 2.1. Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet-llogaritet, si në vijim: 100% për etazhet mbi kuotën ±0.00, 50% për etazhet me vëllim mbi 51% apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës-suteran, dhe 0% për etazhet e nëntokës – bodrum, dhe sipas llogarive, projekt propozimit dhe e miratuar, kjo sipërfaqe është:  
S=2075x2.1=4357.50 m<sup>2</sup> / lejuar sipas planit rregullues /,  
S=5229.00 m<sup>2</sup> / sipas projekt propozimit /.
- Me aplikimin e Vendimit 01 Nr. 400-660 dt.26.05.2008 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin/shpronësimin e pronës private, të planifikuar për interes publik, me koeficient të ndërtimit, do të mundësohet që sipërfaqja e parcelës ndërtimore (brenda vijës rregulluese) të shtohet deri në 20 % të sipërfaqes së përgjithshme të parcelës ndërtimore, dhe sipas kësaj, kjo sipërfaqe, përcaktuar në përqindje (%) është S=415/2075x100=20.00 %. Sipas këtij kalkulimi, pronarët dhe investitori, për sipërfaqen e theksuar, do të kompensohen me sipërfaqen ndërtimore, llogaritur me

koeficient të ndërtimit 2.1,  $S=415 \times 2.1=871.5 \text{ m}^2$ , ndërsa sipërfaqja e përgjithshme ndërtimore, e lejuar, do të jetë ..... $S=4357.50+871.50=5229.00 \text{ m}^2$ .

- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesave të kompleksit, të jetë për banim shumë banesor dhe afarizëm, dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo dhe hapësira garazhesh etj. (sipas projekt propozimit);
- Etazhiteti maksimal për bllokun urban "B3", të tërësisë "Qendra" të Ndryshimi dhe Plotësimi i Planit Rregullues "Arbëria 3", është P+6 etazhe mbi tokë, ku i njëjti etazhiteti mund të ndryshojë me aplikimin e Vendimit 01nr.400-660 dt.26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin e pronës private për interes publik me koeficient të ndërtimit;
- Bazuar në kriteret e planit rregullues, distanca minimale e ndërtesës me kthina primare është  $0.75 \times H$ , kurse me kthina sekondare  $0.25 \times H$ . Me marrëveshje me fqinjët, kjo distancë mund të jetë edhe  $0 \div 0.25 \times H$ . Distanca në mes të ndërtesave të një kompleksi duhet të jetë min.  $1 \times H$ ;
- Ballkonet mund të kalojnë vijën ndërtimore (kur nuk përputhet me vijën rregulluese) më së shumti deri 1.2m. Konzollat më të mëdha se 1.2 m nuk mund të kalojnë vijën ndërtimore, ato duhet të vendosen brenda saj;
- Ngritja e nivelit të përdhese së ndërtesës nga niveli i terrenit - trotuarit të ndërtesës, lejohet të jetë max. 1.20 m, ndërsa, për ndërtesa që në përdhese kanë tregti apo shërbime afariste, kuota e përdhese mund të jetë më e madhe se kuota e trotuarit për (max) 0.30 m;
- Qasja në kompleksin me ndërtesa shumë banesore dhe afariste të jetë nga rrugët e planifikuara të planit rregullues urban, sipas Plani i situacionit - "zgjidhja urbane";
- Për çdo njësi banesore të planifikohet 1 (një) vend parkim, kurse për pjesët afariste të ndërtesës, varësisht prej destinimit, të parashihen vend parkimet, ku për çdo  $40 \text{ m}^2$  (neto)/1 vend parkim;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vendparkimet e jashtme, rrugë të brendshme të kompleksit, mobiliari urban, kënde të lodrave për fëmijë e të ngjashme, si dhe shtigjet dhe trotuarët;
- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth.

**VII. Kompensimi** me koeficient ndërtimi i pjesës së parcelës kadastrale nr. 7178-18, 7178-20, 7178-22 dhe 7178-23 ZK Prishtinë, me sipërfaqe të përgjithshme  $S=415 \text{ m}^2$ , e përfshirë në hapësirë publike të planifikuar-rrugë, është realizuar sipas Marrëveshjes nr.13-464/01-79145/21 dt. 13.09.2021 dhe Aneks Marrëveshjes nr. 13-464/01-79145/21 dt. 21.03.2022 e lidhur në mes të pronarëve Ferat Zariqi, Visar Zariqi, Izet Berisha, Latif Zariqi, Sali Zariqi dhe Drejtorisë së Pronës e realizuar sipas Vendimit për caktimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 20.12.2018 sipas kalkulimeve si në vijim  $S=415/2075 \times 100=20.00 \%$ , pronarët dhe investitori, për sipërfaqen e theksuar, kompensohen me sipërfaqen ndërtimore, llogaritur me koeficient të ndërtimit 2.1,  $S=415 \times 2.1=871.5 \text{ m}^2$ ;

**VIII. Kyçja në infrastrukturë** - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos" - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

**IX. Dokumentacioni ndërtimor/projekti kryesor**, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet

ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimi Administrativ MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinore, "Rregullore MMPH Nr. 03/2016 për normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", bazuar në "Udhëzim Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara", normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit , me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vendndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

**X. Dokumentacioni ndërtimor** - Elaborati për Masat e mbrojtëse nga zjarri hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

**Leja Mjedisore Komunale** – bazuar në nenin 9, pika 1 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, përkatësisht shtojcës së këtij udhëzimi, aktiviteti i propozuar sipas projektit konceptual-kompleks me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, i nënshtrohet procedurës për pajisje me Leje Mjedisore Komunale. Dokumentacioni ndërtimor-Elaborati për Leje Mjedisore Komunale, i hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

*Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:*

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;
- Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

**XI. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore** - meqenëse parcela ndërtimore e krijuar me nr. 10272-0 ZK Prishtinë, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit “arë e klasës 3”, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Plani i situacionit -“zgjidhja urbane”-parcelës ndërtimore, dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej S=2075 m<sup>2</sup>. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrat kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim-pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

**XII. Marrëveshja për infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

**XIII. Pagesa e taksës për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës**, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 Nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si pjesë përbërse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese në kuadër të parcelës kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor

të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënit.

**XIV. Vlefshmëria** e vendimit të kushteve ndërtimore është një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.

### Arsyetim

Aplikuesit/pronarët Ferat Zariqi, Visar Zariqi, Izet Berisha, Latif Zariqi, Sali Zariqi dhe "Pushkolli Group" shpk nga Prishtina, investitorit "Pushkolli Group" shpk, me seli në Vushtrri, me numër unik identifikues nr. 810007759, dhe me person të autorizuar Betim Kokollari nga Vushtrria, sipas kërkesës 05 Nr. 350/03-190763/21 dt. 10.09.2021, kanë kërkuar nga kjo drejtori, miratimin për plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore të caktuara me aktin administrativ "Vendim për caktimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 20.12.2018, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste, në lokacionin e përshkruar në paragrafin III. të dispozitivit të këtij vendimi.

Me kërkesën 05 Nr. 350/03-190763/21 dt. 10.09.2021, si dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës, aplikuesit kanë prezantuar dokumentacionin dhe provat, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr. 10272-0 dhe certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-10272-0 ZK Prishtinë, lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës (kopje e vërtetuar nga origjinali, LRP.Nr.0909/2022, dt. 01.03.2022);
- Projektin konceptual-"zgjidhja urbane", hartuar nga kompania "Vizion Project" shpk, me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 810540345;
- Manualin e incizimit gjeodezik, punuar nga kompania gjeodekte e licencuar "Xhavit M. Gorçaj" shpk me seli në Prishtinë, me licencë nr. 94;
- Aktin administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore" 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 20.12.2018, të kësaj drejtorie (kopje);
- Marrëveshja nr.13-464/01-79145/21 dt. 13.09.2021 dhe Aneks Marrëveshja nr. 13-464/01-79145/21 dt. 21.03.2022 e lidhur në mes të pronarëve Ferat Zariqi, Visar Zariqi, Izet Berisha, Latif Zariqi, Sali Zariqi dhe Drejtorisë së Pronës;
- Aktin noterial "Kontratë për ndërtim dhe investim të përbashkët", e lidhur në mes të pronarëve Ferat Zariqi, Visar Zariqi, Latif Zariqi, Sali Zariqi nga Prishtina me investitorin "Pushkolli Group" shpk, me seli në Vushtrri, me numër unik identifikues nr. 810007759, dhe me person të autorizuar Betim Kokollari nga Vushtrria, redaktuar dhe noterizuar te noteri Learte F. Cana, në Prishtinë, LRP-Nr. 0902/2022, Ref.nr. 0307/2022, dt. 01.03.2022 (kopje e vërtetuar nga origjinali);
- Aktin noterial "Kontratë për ndërtim dhe investim të përbashkët", e lidhur në mes të pronarit Izet Berisha dhe investitorit "Pushkolli Group" shpk, me seli në Vushtrri, me numër unik identifikues nr. 810007759, dhe me person të autorizuar Betim Kokollari nga Vushtrria, redaktuar dhe noterizuar te noteri Learte F. Cana, në Prishtinë, LRP-Nr. 10561/2020, Ref.nr. 2325/2020, dt. 30.09.2020 (kopje e vërtetuar nga origjinali);
- Aktin noterial "Autorizim", dhënë nga "Pushkolli Group" shpk, me pronar z. Ridvan Pushkolli nga Vushtrria, për z. Betim Kollari nga Vushtrria për përfaqësim, redaktuar dhe vërtetuar te noteri Faton R. Muslija, në Prishtinë, me LRP.nr. 912/2021, dt.12.02.2021 (kopje e vërtetuar nga origjinali);
- Aktin Noterial "Pëlqim" LRP. Nr. 17312/18 dt. 31.08.2018, i ndërsjellt për lejimin e ndërtimit në kufi të parcelës;
- Vërtetimin mbi obligimet tatimore, në emër të Visar Zariqi, nr. 44542/22 dt. 01.03.2022;
- Vërtetimin mbi obligimet tatimore, në emër të Ferat Zariqi, nr. 46456/22 dt. 03.03.2022;
- Vërtetimin mbi obligimet tatimore, në emër të Izet Berisha, nr. 176295/22 dt. 26.07.2022;
- Vërtetimin mbi obligimet tatimore, në emër të Sali Zariqi, nr. 171924/22 dt. 21.07.2022;
- Vërtetimin mbi obligimet tatimore, në emër të "Pushkolli Group" shpk. nr. 176295/22 dt. 26.07.2022;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit "Pushkolli Group" shpk, nr 810007759;
- Kopjen e letërnjoftimit të pronarëve dhe të investitorit;
- Fotot e lokacionit.

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit të kërkesës 05 Nr. 350/03-190763/21 dt. 10.09.2021, për miratimin për plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore të caktuara me aktin administrativ "Vendim për caktimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 20.12.2018, apo ricaktimin e kushteve ndërtimore, pas shqyrtimit të saj, konsultimit të dosjes së lëndës/kërkesës për caktim të kushteve ndërtimore 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 24.09.2018, me dokumentacionet e prezantuara, të dosjes së lëndëve paraprake për lokacionin si dhe provave tjera, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për hapësirën ku gjendet lokacioni - Ndryshimi dhe Plotësimi i Planit Rregullues "Arbëria 3", rregullativës ligjore nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, projekt propozimit/ projektit konceptual me "zgjidhja urbane" të prezantuar me kërkesë, si dhe rrethanat dhe provat/faktet për vendosje, në mënyrë kronologjike, ka konstatuar se:

Drejtoria e Urbanizmit, bazuar në kërkesën 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 24.09.2018, në emër të pronarëve Ferat Zariqi, Visar Zariqi, Izet Berisha, Latif Zariqi, Sali Zariqi nga Prishtina, me investitor NNP "Standard" shpk, me adresë në lagjen "Dardania", SU1/3A, në Prishtinë me nr. të biznesit 80100540, përfaqësuar nga Vehbi Zariqi, me aktin administrativ "Kushteve Ndërtimore" 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 20.12.2018, ka caktuar kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e ndërtesave shumëbanesore me afarizëm "B", me etazhitet 2B+S+P+5 dhe "C", me etazhitet 2B+S+P+5, në kuadër të bllokut urban "B3.2", të bllokut urban "B3", të tërësisë hapësinore "Qendra", të Ndryshimit dhe Plotësimit të Planit Rregullues "Arbëria 3" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 7178-1, 7178-2, 7178-3, 7178-4, 7178-6 dhe në pjesë të parcelës kadastrale 7178-13 ZK Prishtinë, në harmoni me dokumentin e planifikimit hapësinor, dhe bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, si dhe projekt propozimin e kërkuar.

Investitori "Pushkollli Group" shpk me seli në Vushtrri, me përfaqësues Ridvan Pushkollli nga Vushtrria, pas njoftimit me aktin administrativ "Kushte Ndërtimore" 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 20.12.2018, dhe arritjes së marrëveshjes për bashkëinvestim me pronarët e parcelave kadastrale, për të cilat janë caktuar kushtet ndërtimore, bazuar në aktin administrativ të referuar, në bashkëveprim dhe bashkëpajtim edhe me pronarët/bashkëpronarët e parcelave kadastrale, për të cilat janë caktuar kushtet ndërtimore, me kërkesën 05 Nr. 350/03-190763/21 dt. 10.09.2021, kanë kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit, miratimin e ndryshimit të kushteve ndërtimore të caktuara me aktet administrative, të referuara në këtë paragraf, në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10272-0 ZK Prishtinë si dhe trajtimin e parcelave kadastrale nr. 7178-18, 7178-20, 7178-22, dhe 7178-23 ZK Prishtinë, me sipërfaqe S=415 m<sup>2</sup>, bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 400-660 dt. 26.05.2008, për të cilën është përfunduar procedura për shpronësimin/kompensimin me koeficient të ndërtimit (e njëjta ka kaluar në pronësi komunale), sipas aktit administrativ "Kushte Ndërtimore" 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 20.12.2018, të caktuara nga kjo drejtori, duke prezantuar edhe projekt propozimin/Plani i situacionit-"zgjidhja urbane".

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit të kërkesës 05 Nr. 350/03-190763/21 dt. 10.09.2021, për miratimin për plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore, me dokumentacionin e bashkangjitur, duke u mbështet në nenin 53 dhe 84 të të njëjtit ligj, vendosi që aktin administrativ "Kushte ndërtimore", 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 20.12.2018, ta shfuqizojë, përkatësisht të ricaktojë kushtet ndërtimore për ndërtesën shumë banesore dhe afariste, ta pranojë ndërrimin e investitorit në procedurë dhe sërish të caktojë kushtet ndërtimore, tani për parcelat kadastrale nr. 10272-0 ZK Prishtinë, me trajtimin e parcelave kadastrale nr. 7178-18, 7178-20, 7178-22 dhe 7178-23 ZK Prishtinë, me sipërfaqe të përgjithshme S=415 m<sup>2</sup>, të shpronësuar sipas Marrëveshjes nr.13-464/01-79145/21 dt. 13.09.2021 dhe Aneks Marrëveshjes nr. 13-464/01-79145/21 dt. 21.03.2022 e lidhur në mes të pronarëve Ferat Zariqi, Visar Zariqi, Izet Berisha, Latif Zariqi, Sali Zariqi dhe Drejtorisë së Pronës, bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 400-660 dt. 26.05.2008 dhe "Kushte Ndërtimore" 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 20.12.2018.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kycje të kompleksit në rrugën e planifikuar të planit rregullues, si dhe organizimin e vendparkimeve, në kuadër të atij kompleksi, dhe është konstatuar, si në vijim:

"Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Ferat, Latif, Salih, Visar Zariqi dhe Izet Berisha me inv. "Pushkollli Group" shpk me seli në Vushtrri, me përfaqësues Ridvan Pushkollli



nga Vushtrria,, lidhur me kërkesën 05 Nr. 350/03-190763/21 dt. 10.09.2021, për miratimin për plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore, kyçja për automjete, në rrugën e planifikuar në lagjen “Arbëria 3”, për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, me etazhitet 2B+S+P+7, të prezantuar si në situacion, mund të pranohet si e till, duke marrë parasysh kategorinë e rrugës së planifikuar dhe shmangies së kyçjes në raport me udhëkryqet e rrugëve të planifikuara. Në fazat e ardhshme të projektimit dhe realizimit të ndërtesave banesore me afarizëm për rampa dhe vend parkime, duhet të aplikohen kriteret sipas “Rregullores për Normat Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi”, dhe të arrihen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes. Gjerësia e rrugës kaluese me qarkullim dy kahor përgjatë hapësirave të vend parkimeve të jashtme dhe të brendshme në garazha, duhet të jetë minimum 5.5m. Ndryshime në rrugë të planifikuar sa i përket regjimit të trafikut me qëllim të favorizimit të ndërtesave banimore afariste nuk duhet të ketë. Kyçja duhet të harmonizohet dhe të përshtatet me profilin e rrugës edhe në kohën kur realizohet ajo.

Bazuar në konstatimet e më sipërme dhe në dokumentacionin e shqyrtuar, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe nenin 13 të “Udhëzim Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, nenin 44, 53, 57 dhe 84 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Drejtoria e Urbanizmit, vendosi që të miratojë kërkesën 05 Nr. 350/03-190763/21 dt. 10.09.2021, për plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore të caktuara me aktin administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 20.12.2018, ndërrimin e investitorit në procedurë dhe ricaktimin e kushteve ndërtimore, përkatësisht të shfuqizojë aktin, dhe sërish të caktojë kushtet ndërtimore, dhe kërkesën me faktet-provat e prezantuara, ta trajtojë sipas rregullativës ligjore në fuqi, me ç’rast të konstatoi se kërkuessit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit-“zgjidhja urbane”, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për ricaktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

**Shtojcë:** Dispozita urbanistike-”zgjidhja urbane” me ndërtesa të planifikuara dhe situacioni me vijë rregullues dhe ndërtimore me parcelë kadastrale në Sistemin Koordinativ KOSOVAREF 01.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do ti përcillet organit epror – MMPHI-së.

**Ky vendim u printua në 5 (pesë) kopje identike dhe i dërgohet:** Aplikuesve/Investitorit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05 Nr. 350/02-0232206/18 dt. 24.09.2018 dhe 05 nr. 350/02-190763/21 dt. 10.09.2021.

**I dërgohet përmes postës elektronike:** Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 350/03-190763/21 DT. 26.07.2022**

Zyrtari,  
Mimoza Berisha Preatreshi

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi

Drejtori,  
Arber Sadiki





